



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo



Komuna e Mitrovicës së Jugut
Opština Juzna Mitrovica – Municipality of Mitrovica South

KUVENDI I KOMUNËS SË MITROVICËS SË JUGUT

Komiteti për Politikë dhe Financa

Nr. 02-060/01-0055148-1/23 dt. 25.07.2023

Mitrovicë

PROCESVERBAL

Nga mbledhja urgjente e Komitetit për Politikë dhe Financa
Mbledhja e 21-të

Koha: 25.07.2023 ora 10:00
Vendi: Salla e Mediave
Të pranishëm: Kryesuesja e Kuvendit znj. Vesa Broja
Anëtarët e Komitetit për Politikë dhe Financa: Fadil Veseli, Nazmije Sejdiu, Shkurta Shosholli Musa, Hysen Muzliukaj, Erseka Barani, Muhamed Hoti dhe Xhyljeta Imeri
Kryetari i Komunës z. Bedri Hamza
Drejtorët e Drejtorive
Mungoi: Vesel Neziri

Mbledhjen e hapi dhe kryesoi Kryesuesja e Kuvendit znj. Vesa Broja e cila theksoi se në zbatim të nenit 44, paragrafi 6, të Ligjit Nr. 03/L-040 Për vetëqeverisjen lokale; nenit 62, të Statutit të Komunës së Mitrovicës, për sot ka thirrur mbledhjen urgjente të Komitetit për Politikë dhe Financa, me këtë:

Rend dite:

1. Propozim-vendim për transfer dhe rialokim të mjeteve financiare

Rendi i ditës u miratua unanimisht.

Pika 1

Kryesuesja znj. Vesa Broja para se të hapë diskutimin lidhur me Propozim vendimin për transfer dhe rialokim të mjeteve financiare, për ta arsyetuar të njëjtin fjalën ia kaloi Kryetarit të Komunës z. Bedri Hamza.

Kryetari Bedri Hamza: Propozim vendimi për transfer dhe rialokim të mjeteve financiare është në harmoni të plotë me Ligjin për menaxhimin e financave. Qëllimi i këtij propozim-vendimi është transferi dhe rialokimi i mjeteve financiare deri në 15%. Në këtë propozim janë të cekura projektet dhe kodet nga ku do të merren dhe ku do të vendosen këto mjete, prandaj pres mirëkuptimin tuaj që propozim-vendimi të miratohet dhe të procedohet në Kuvend në seancën e nesërme për shqyrtim dhe miratim.

Xhyljeta Imeri: Kam një pyetje, të njëjtin ia kam shtruar drejtorisë përkatëse por nuk më është përgjigjur, fjala është për ndërtimin e çerdhes në Shipol, deri ku kanë shkuar procedurat dhe a mund të jetë e gatshme për muajin shtator ashtu siç është planifikuar.

Kryetari Bedri Hamza: Çerdhja në Shipol së bashku me ambulancën në Koshtovë dhe atë në Gushavc janë të kontraktuara nga i njëjti operator, ky operator ekonomik nuk ka mundur ta përfundoj punën dhe kontrata ka skaduar. Në bazë të Ligjit për menaxhimin e financave ne si komunë për punën e kryer ua kemi transferuar mjetet, ndërsa për punën e mbetur kemi filluar procedura tjera të prokurimit. Sa kam informata ende nuk është zgjedhur operatori, besoj se për muajin tetor ose nëntor do të jetë e gatshme.

Hysen Muzliukaj: Pasi operatori ekonomik nuk e ka përfunduar punën sipas kontratës, ju si Komunë a keni marrë ndonjë masë, a i keni penalizuar siç është paraparë me ligj, si dhe sa kam informata unë i njëjti operator është kontraktuar edhe për ndërtimin e çerdhes në Iliridë, a besoni se do ta përfundojë punën brenda afatit apo prapë do ta lë pa përfunduar sikur me tri projektet tjera. Sa i përket propozim vendimit jam dakord që të miratohet por herëve tjera të kihen parasysh afatet.

Kryetari Bedri Hamza: OSHP-ja ka filluar që operatorëve ekonomik të cilët nuk i kryejnë punët brenda afateve të parapara me kontratë t'iu merren mjetet, këtë gjë ne e kemi kërkuar sa herë, prandaj ndaj operatorëve që nuk i kryejnë punët në përputhje me kontratën e nënshkruar të merren masat e nevojshme. Sa i përket çështjes së çerdhes në Iliridë, ky projekt është financuar nga MASHT-i dhe ata i kanë kryer procedurat e prokurimit.

Hysen Muzliukaj: Trendi i dhënies së avansit operatorëve ekonomik për mua është gabim, sepse operatorët ekonomik me marrjen e avansit po i stërzgjin punët, nuk po ka dinamikë të punës, për çdo kontratë që nënshkruhet ekziston menaxheri i kontratës i cili duhet të jap llogari për mosrespektim të kontratës, Komisioni mbikëqyrës po ashtu duhet të shikoj se a ka plan dinamik për atë punë dhe a është respektuar.

Kryetari Bedri Hamza: Avansi është një e drejtë e garantuar me ligj, prandaj na duhet respektuar, vitin tjetër buxheti është i plotë dhe nuk ka asnjë arsye për tu zvarritur punët, pa i kryer të gjitha obligimet kontraktuale ligjore nuk do të ketë projekte të reja.

Fadil Veseli: Bartja e 208.000 € është e arsyeshme dhe specifike, është pozitive sepse bartja bëhet prej kodi në kod, kodet janë të specifikuara veç e veç, bartja e ka arsyeshmërinë e vet, po shfrytëzohen këto mjete financiare, por kryhen punët dhe mjetet nuk po shkojnë në suficit.

Kryetari Bedri Hamza: Ligjvënësit i kanë paraparë të gjitha këto, prandaj pres që të miratohet ky propozim vendim dhe të shkoj për miratim nesër në Kuvend.

Pasi nuk kishte të lajmëruar tjerë për diskutim, Kryesuesja vuri në votim Propozim vendimin për transfer dhe rialokim të mjeteve financiare.

Propozim vendimi për transfer dhe rialokim të mjeteve financiare u miratua unanimitisht (8-për, 0-kundër dhe 0-abstenime) dhe i njëjti i procedohet Kuvendit të Komunës për shqyrtim dhe miratim.

Mbledhja përfundoi punimet në ora 10:50 min.

Mitrovicë

Procesmbajtës:

Merita Preteni
Merita PRETENI

Kryesuesja e Kuvendit

Vesa Broja
Vesa BROJA

